



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 74 /2021

Datë: 27 / 04 2021

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019) si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4), nenin 25 dhe 26 (paragrafi 3) të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021), Ministrja e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Tea Blakaj, emërohet Këshilltare e Jashtme e Ministres së Drejtësisë e cila nuk paguhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nuk shkakton shpenzime për Buxhetin e Kosovës.
2. E emëruara nga pika 1 e këtij vendimi ushtron përgjegjësitë e saj në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021) dhe termat e referencës të parapara nga ana e projektit EUKOJUST sipas marrëveshjes me Ministrinë e Drejtësisë.
3. Mandati i të emëruarës në pikën 1 të këtij vendimi fillon me datë 22 prill 2021 dhe për aq sa zgjatë marrëveshja ndërmjet ministrisë dhe projektit nga paragrafi paraprak.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Të emëruarës Znj. Tea Blakaj;
- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.